

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr 400-8932

Dt: 13.01.2016


Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 11, 13 dhe 58.a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 5,9 dhe 10 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale dhe Përfundimit 01 nr.06-16174-3/1 i miratuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur me dt: 26.02.2015, për mbështetje të asistencës në verifikimin e plotë të të gjitha rasteve sociale në Komunën e Gjakovës, me dt: 12.01.2016 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet raporti i punës së OJQ “Femrat Aktive të Gjakovës” për asistencë në verifikimin e plotë të të gjitha rasteve sociale në Komunën e Gjakovës, duke e mbështetur me subvencione komunale në vlerë prej 3,000.00€ .
2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 3,000.00€, nga mjetet e subvencioneve të Zyrës së Kryetares dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirrollogarinë e OJQ “Femrat Aktive të Gjakovës” nr. 1140096707000188 Pro Credit Bank .
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .
4. Vendimi iu dërgohet :
 - Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim
 - Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
 - Znj. Valbona Doli Rizvanolli, udhëheqëse e OJQ ”Femrat Aktive të Gjakovës”
 - Arkivit

Kryetarja e Komunës

Znj. Mimoza Kusari- Lila



PROCESVERBAL

Në bazë të vendimit të Bordit të drejtorëve të Komunës së Gjakovës të dt.19.06.15 është caktuar komisioni për zgjedhjen e OJQ-ve që do të ndihmojnë në realizimin e planit tre vjeçar të banimit për Komunën e Gjakovës në përbërje nga këta anëtar:

1. Vjollca Dujaka ,kryesuese e komisionit *Vjollca Dujaka*
2. Ali Tafarshiku, anëtar *Ali Tafarshiku*
3. Kelmend Vula, anëtar *Kelmend Vula*
4. Elida Bejtullahu, anëtare *Elida Bejtullahu*
5. Armend Behluli, anëtar *Armend Behluli*

Komisioni në fjalë është mbledh me dt.02.10.15 dhe ka shqyrtuar dokumentacionin e ofruar nga ana e dy(2) OJQ-ve të paraqitura në bazë të- **thirrjes për aplikim - nr.01nr 06-16174-3** si dhe bazuar në Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve të Komunës së Gjakovës, neni i 7 i cili përcakton kompletimin e dokumenteve për ndarjen e subvencioneve.

Thirrjes për aplikim u janë bashkangjitur dy organizata siç janë:

- FEMRAT AKTIVE TË GJAKOVËS dhe
- SHEPF-SHOQATA PER EDUKIM DHE PER KUJDESJEN E FAMILJES,

Komisioni pas shikimit të dokumentacionit si dhe konsultimeve ka vendosur që përfitues i këtij projekti të jenë OJQ – FEMRAT AKTIVE TË GJAKOVËS - bazuar në dokumentacionin e kërkuar në thirrjen për aplikim.

OJQ-ja në fjalë ka përparësi sepse ka sjell planin e punës më të detajuar , letra reference lidhur me punët e kryera më herët si dhe të dhënat për stafin e kompletuar mirë.